



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.9766/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i gjykatës Valon Totaj, me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Xh.B, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.B.K nga Prizreni, kundër debitores Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, të cilën e përfaqëson i autorizuari B.O, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec PPP.nr.75/21, të datës 14.07.2021, me datën 31.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitores Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec PPP.nr.75/21, i datës 14.07.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec me pikën I të dispozitivit të ankimuar PPP.nr.75/21, të datës 14.07.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitores Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.16/21, i datës 12.01.2021, i lejuar nga zyra përmbarimore e përmbaruesit privat E.H në Prizren, ndërsa në pikën II ka vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit do t'i bart ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor-përmbarimor.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitorja për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ankesa e debitorit të aprovohet, të anulohet urdhri përbarimor P.nr.16/21, i datës 12.01.2021 i përbaruesit privat E.H, respektivisht aktvendimi PPP.nr.74/21, i datës 14.07.2021 i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, të shfuqizohet ose të prishet, apo që lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitores, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë ankesën e kësaj të fundit si të pathemeltë.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore dhe në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), në lidhje me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- ankesa e debitores, **është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 12.01.2020, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitores në bazë të dokumentit përbarues vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.../2020, të datës 29.12.2020, më gjerësisht sikurse në propozimin për përbarim.

Përbaruesi Privat E.H ka nxjerr urdhrin P.nr.16/2021, të datës 12.01.2021, me të cilin e ka lejuar propozimin për përbarim.

Kundër urdhrin mbi lejin e përbarimit debitorja ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri përbarimor P.nr.16/2021, i datës 12.01.2021. Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitores. Duke vendosur mbi prapësimin e debitores, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar PPP.nr.75/21, të datës 14.07.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitores kundër urdhrin përbarimor P.nr.16/2021, të datës 12.01.2021.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se debitori në prapësim nuk është thirrur në asnjë shkak për paraqitjen e prapësimit të paraparë me dispozitën e nenit 71 të LPP. Tutje ka shtuar se në rastin konkret nga shkresat e lëndës shihet se propozimi për përbarim është bërë mbi bazën e Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.../2020, të datës 29.12.2020, e që konform nenit 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP paraqet dokument përbarues dhe është i përshtatshëm për përbarim në kuptim të dispozitës së nenit 27 të LPP-së ngase i përmban të gjitha elementet që i parasheh dispozita e lartcekur duke përfshirë kreditorin, debitorin, objektin, mjetet e përbarimit shumë dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Më tej ka arsyetuar se gjykata i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palës debitore të paraqitura në prapësim lidhur me kompetencën e Inspektoratit të Punës për të nxjerrë vendime administrative, por të njëjtat kanë rezultuar si të pabazuara, për shkak se kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në procedurë tjetër e asesi në këtë procedurë, për shkak se kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal në bazë të cilit gjykatës i ndalohe vlerësimin e rrethanave tjera përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit përmbarues. Tutje ka shtuar se i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera lidhur me ndaljen e përbarimit për shkak të inicimit të konfliktit administrativ e që edhe ky pretendim nuk qëndron për shkak se me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ. Vendimin lidhur me shpenzimet e ka mbështetur në dispozitën e nenit 13 të LPP-së dhe 450 të LPK.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Pretendimet ankimore të debitorës se dispozitivi i aktvendimit të atakuar, është përfshirë me shkelje të nenit 182, pika n) të LPK, se ka mangësi dhe është i pa kuptimtë, se respektivisht i kundërshtohet vetvetes dhe arsyeve të aktvendimit, janë tërësisht të pa bazuara, pasi që dispozitivi është i qartë, dokumenti përmbarues paraqet titull ekzekutiv në pajtim me dispozitat e LPP, dhe se lidhur me vendosjen, janë dhënë arsyet e duhura, sikurse në aktvendimin e atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i lëshuar nga Inspektorati i Punës Nr.../2020, të datës 29.12.2020, në rastin konkret është dokument përmbarues. Kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP e cila dispozitë përcakton se *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21 të LPP, i cili përcakton se *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP me të cilin përcaktohet se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Me nenin 27 paragrafi 1 të LPP, përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj edhe pretendimet e debitorit se gjykata ka bërë shkelje të

dispozitave të procedurës përbarimore dhe materiale me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përbarimin.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet e tjera të debitorit lidhur me kompetencën e Inspektoratit të Punës për të nxjerrë vendime administrative, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata në procedurë përbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përbarimit dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata e shkallës i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP.

Nuk janë pranuar pretendimet e debitorit lidhur me atë se vendimi i Inspektoratit të Punës nuk paraqet titull ekzekutiv dhe nuk i ka tiparet e përbarueshmërisë, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dispozitën e nenit 24 paragrafi 5 të LPP-së përcaktohet se: *“Përbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin”*, ndërsa me Ligjin për Inspektoratin e Punës në Kosovë LIGJI Nr. 2002/9, në nenin 6.4 është përcaktuar se: *“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”*, ndërsa me dispozitën e nenit 144 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji Nr. 05/L -031, përcaktohet se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues”*.

Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka lejuar përbarimin dhe refuzuar prapësimin e debitorit, pasi që në kuptim të dispozitave të lart cituara përbarimi mund të lejohet edhe në rastet kur vendimi i dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtar vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin, me çka në rastin konkret ankesa e ushtruar në procedurë administrative ndaj vendimit të nxjerrë në atë procedurë nuk ka pasur efekt suspensiv gjegjësisht nuk ka shtyrë ekzekutimin e vendimit ashtu që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së tij, andaj edhe në këtë drejtim mbi bazën e këtij vendimi mund të lejohet përbarimi, pasi që ankesa e paraqitur nuk e ka ndaluar ekzekutimin.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore të debitores për të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta, për faktin se në këtë çështje juridike përmbarimore përmbarimi është lejuar në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.../2020, të datës 29.12.2020, i cili i plotëson kushtet për përmbarim dhe është i përshtatshëm për përmbarim e po ashtu paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit dhe rrjedhimisht ankesa rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9766/2021, me datën 31.05.2022

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj